



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË**



**Përmbledhje**

**E MBLEDHJES SË TETË TË KOMITETIT KOMBËTAR TË SISTEMIT TË  
PAGESAVE (KKSP)**

e cila u mbajt

të mërkurën, datë 9 Nëntor 2022, nga ora 09:00 deri 13:00 organizuar pranë Bankës së Shqipërisë.

Në datën 9 nëntor u zhvillua mbledhja e tetë e Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave (KKSP). Mbledhja u drejtua nga Kryetarja e Komitetit, Zj. Luljeta Minxhozi, Zëvendësguvernatore e Parë e Bankës së Shqipërisë.

Në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave, si: Kryetari dhe Sekretari i Shoqatës Shqiptare të Bankave, dhe Kryetari i Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave, përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF), Shoqata Mikrofinanciare Shqiptare, si dhe institucione financiare banka dhe jobanka, përfaqësues të operatorëve të skemave kombëtare të pagesave. Në mbledhje ishin të ftuar edhe një sërë aktorësh të rëndësishëm me qëllim mbështetjen e tematikave të zhvilluara gjatë mbledhjes ku mund të përmendet Banka Botërore.

Mbledhja u hap nga Kryetarja e KKSP Zj. Minxhozi, e cila në fjalën e saj hyrëse falënderoi pjesëmarrësit për mbështetjen aktive në kuadër të përmbushjes së objektivave të Strategjisë Kombëtare të Pagesave me Vlerë të Vogël (2018-2023). Zj. Minxhozi i kushtoi vëmendje modernizimit të sistemit të pagesave si dhe ligjit “Për shërbimet e pagesave” i cili tashmë është finalizuar si nga pikëpamja infrastrukturore ashtu edhe rregullative, dhe është funksional dhe i disponueshëm për aktorët e tregut. Kryetarja mbylli fjalën e saj duke theksuar se bashkëpunimi me institucionet në përmbushje të synimeve të përbashkëta ka qenë efektiv. Gjithashtu sfidat janë përpara në lidhje me digjitalizimin dhe përfshirjen financiare, tema të cilat do të diskutohen edhe në këtë mbledhje.

Në vazhdim fjalën e mori Guvernatori Z. Sejko i cili u shpreh se Banka e Shqipërisë në rolin e autoritetit monetar, rregullator e mbikëqyrës, vlerëson përfshirjen financiare dhe edukimin financiar, si dy objektiva strategjikë mjaft të rëndësishëm për stabilitetin monetar e financiar të vendit, formalizimin e ekonomisë dhe zhvillimin e qëndrueshëm të saj. Në këtë kuadër, masat e

marra deri më tani kanë reflektuar zhvillime mjaft pozitive në treg, duke bërë të mundur përmbushjen e objektivave sasiorë të synuar, pothuajse në gjysmën e rrugëtimit të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Pagesave me Vlerë të Vogël. Guvernatori Sejko shtoi se në vitin 2021 është arritur një nivel i përdorimit të pagesave elektronike prej 12.5 pagesash për frymë në vit, duke tejkaluar edhe objektivin e synuar të Strategjisë prej 10 pagesash deri në fund të vitit 2023, ndërkohë që, në vitin 2022, vlerësohet se kjo shifër do të arrijë nivelin prej 16 pagesash për frymë.

Guvernatori Sejko u shpreh se këta tregues janë dëshmi e rritjes së përdorimit të instrumenteve elektronike nga konsumatorët, gjë që ndikon pozitivisht edhe në formalizimin e ekonomisë. Falë të dhënave nga Regjistri Kombëtar i Llogarive, Banka e Shqipërisë disponon një pamje më të saktë dhe lehtësisht të përditësueshme mbi përfshirjen financiare të popullsisë. Këto të dhëna diktojnë se shqiptarët kanë një nivel relativisht të kënaqshëm të përfshirjes financiare, ku pothuajse 69% e popullsisë zotëron një llogari. *“Objektivi ynë fillimisht ishte arritja e një niveli të përfshirjes financiare të popullsisë në masën 70%, por vlerësojmë se në periudhën afatshkurtër, ky nivel do të tejkalohet, duke shënuar përafrim të ndjeshëm me vendet e Ballkanit dhe ato të Bashkimit Evropian.”* – tha Guvernatori. Nga ana tjetër Z. Sejko u shpreh se krahas zhvillimeve ligjore e rregullative, Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë edhe një sërë masash të tjera, si krijimi dhe operimi i sistemit AIPS-EURO për pagesat ndërbankare në Euro brenda vendit. Bazuar në matjet dhe analizat e Bankës së Shqipërisë mund të thuhet se projekti ka efekte të drejtpërdrejta dhe të tërthorta në mirëqenien individuale të klientit, të bankës, si dhe të ekonomisë në tërësi. Në këtë drejtim, vlen të theksohet se që prej muajit maj, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, AKSH-i dhe sistemi bankar po bashkëpunojnë ngushtë, me qëllim krijimin e të gjitha alternativave të mundshme për kryerjen e pagesave në distancë, nëpërmjet mjeteve elektronike. Arritja e një qëllimi të tillë është shumë domethënëse në nxitjen e përfshirjes financiare, edukimit dhe familjarizimit të publikut me përdorimin e pagesave elektronike. Z. Sejko theksoi se, me qëllim mbështetjen e zhvillimeve të tregut, Banka e Shqipërisë po punon gjithashtu edhe në drejtim të përmirësimit të sistemeve të pagesave për prezantimin e standardeve të reja të komunikimit dhe shërbimeve, të cilat ndihmojnë në adresimin e nevojave infrastrukturore për zbatimin e strategjisë. Gjithashtu, së bashku me aktorët e tregut, ne do të intensifikojmë përpjekjet për realizimin e projektit Instant Payment.

Z. Sejko mbylli fjalën e tij, duke u shprehur se e fundit por jo më pak e rëndësishme, në kuadër të materializimit sa më efikas të masave të analizuara në këtë strategji dhe më gjerë, po punohet për krijimin dhe zbatimin e një Strategjie Kombëtare për Edukimin Financiar.

Në vijim fjalën e mori Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Zj. Delina Ibrahimaj. Në fjalën e saj, Zj. Ibrahimaj përmendi një sërë projektesh të ndërmarra nga ministria dhe qeveria, të cilat mbështesin digjitalizimin e shërbimeve qeveritare dhe formalizimin e ekonomisë shqiptare, duke u ndërlidhur ngushtë me objektivat e Strategjisë Kombëtare të Pagesave me Vlerë të Vogël. Në

këtë kuadër, Zj. Ibrahimaj i kushtoi vëmendje procesit të fiskalizimit dhe ligjit “Për shërbimet e pagesave”, të cilët, pavarësisht se rregullojnë fusha të ndryshme, ndërlihen me njëri-tjetrin për digjitalizimin tërësor të procesit. Gjithashtu, Zj. Ministre përmendi edhe lehtësitë që krijon Regjistri Kombëtar i Llogarive për matjen dinamike të përfshirjes financiare të popullsisë. Një hap i rëndësishëm në kuadër të përfshirjes financiare i ndërmarrë nga qeveria është edhe kalimi i pensioneve nëpërmjet postës shqiptare dhe krijimi i projektit të kartës sociale.

Në vijim, Ministria Ibrahimaj theksoi bashkëpunimin e vazhdueshëm të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me Bankën e Shqipërisë për nisma të ndryshme ligjore, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë projektligjit “Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike”, si dhe nënshkrimin e një Memorandumi Mirëkuptimi midis MFE-së, BSH-së, AKSH-it dhe SHSHB-së, në lidhje me digjitalizimin e pagesave për shërbime shtetërore e publike.

Pas fjalimeve përshëndetëse, mbledhja vijoi me diskutime në nivel teknik. Seksioni i parë i mbledhjes së tetë u udhëhoq nga Zëvendësguvernatorja Minxhozi, diskutimet u fokusuan në edukimin financiar dhe nevojën për një ndërhyrje strategjike në nivel kombëtar në këtë drejtim. Në këtë drejtim aktorë të rëndësishëm si Banka e Shqipërisë, përfaqësuar nga Z. Altin Tanku, Drejtori i Departamentit të Kërkimeve, trajtoi në mënyrë konkrete Strategjinë Kombëtare të Edukimit Financiar duke konsideruar të rëndësishme diagnostifikimin e problematikave në rang vendi dhe mundësitë e zbatimit të saj në praktikë.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare i përfaqësuar nga Zj. Mimoza Kaçi, prezantoi nismat e këtij institucioni në lidhje me edukimin financiar dhe bashkëpunimin e ngushtë me Bankën e Shqipërisë.

Ndërkohë, Zj. Edlira Dashi, përfaqësuese e Bankës Botërore, bëri një analizë të thelluar të situatës në Shqipëri, si dhe prezantoi praktikën më të mira dhe hapat e nevojshëm për të ardhmen në lidhje me Strategjinë Kombëtare të Edukimit Financiar.

Mbledhja e tetë e KKSP-së vijoi me panelin e dytë, të udhëhequr nga Z. Spiro Brumbulli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Shoqatës Shqiptare të Bankave, i cili u fokusua në promovimin e inovacionit të tregut nëpërmjet open banking dhe instant payment. Fillimisht, Z. Bledar Shella, Kryetar i Shoqatës Shqiptare të Bankave, prezantoi zhvillimet dhe projektet më të fundit të tregut, të cilat diktojnë qartazi inovacionin dhe digjitalizimin e tregut të pagesave në Shqipëri.

Në vazhdim, mbledhja vijoi me një çështje mjaft të rëndësishme për tregun, por dhe për përmbushjen e Strategjisë Kombëtare të Pagesave me Vlerë të Vogël dhe që lidhet me kuadrin rregullativ në zbatim të ligjit “Për shërbimet e pagesave” i cili dikton kriteret dhe kërkesat që duhet të plotësojnë si institucionet ekzistuese ashtu dhe aktorët e rinj në treg. Një çështje me interes të veçantë ishte dhe rregullimi i komunikimit për APIs (*Application Program Interfaces*) dhe

konceptin e bankës së hapur (*open banking*) dhe mbi autentifikimin e thelluar të klientit, elemente këto që plotësojnë të gjithë kuadrin e nevojshëm për promovimin e inovacionit në treg, nëpërmjet zbatimit të rregullores, "Për autentifikimin e thelluar të klientit dhe standardet e përbashkëta, të hapura dhe të sigurta të komunikimit" e cila është miratuar dhe pritet të hyjë në fuqi në janar të vitit 2024. Këto zhvillime u prezantuan nga Z. Deniz Deralla, Drejtor i Departamentit të Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë.

Diskutimet e këtij paneli përfunduan me prezantimin e gjetjeve të Bankës së Shqipërisë nga studimi i realizueshmërisë së projektit Instant Payment në Shqipëri, i prezantuar nga Zj. Valentina Semi, Zëvendësdrejtoreshë pranë Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës. Në kuadër të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Pagesat me Vlerë të Vogël në Shqipëri, i cili është rezultat i angazhimit të përbashkët të aktorëve publikë dhe privatë shqiptarë, nën drejtimin e Bankës së Shqipërisë kemi vijuar punën për përfundimin e projektit për pagesat e shpejta (*instant payment*) ku është finalizuar një raport "Shqipëria- një analizë mbi implementimin e opsioneve të ndryshme për Sistemin e Pagesave të shpejta". Në rastin e Shqipërisë, kjo risi në fushën e pagesave synon zgjerimin e shërbimeve dhe instrumenteve të pagesave dhe shërbimeve të Pagesave, nxitjen e konkurrencës edhe midis instrumenteve të ndryshëm me qëllim reduktimin e kostove si dhe mbulimin e segmenteve të tregut të cilat nuk kanë përdorim të instrumenteve elektronike. Zj. Semi përfundoi prezantimin e saj, duke përmendur se nxitja e përfshirjes financiare përbën një domosdoshmëri dhe parakusht për zbatimin e një projekti të suksesshëm dhe me përdorim të lartë nga tregu.

Në panelin e tretë dhe të fundit të kësaj mbledhjeje, të udhëhequr nga Zj. Brunilda Isaj, Sekretare e Përgjithshme pranë Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare, fokusi u vu në shërbimet inovative të ofruara nga aktorë të ndryshëm të tregut, në linjë me Strategjinë Kombëtare të Pagesave me Vlerë të Vogël dhe ligjin "Për shërbimet e pagesave".

Në përfundim, duke u bazuar në diskutimet e mbledhjes, Kryetarja e KKSP, Zëvendësgovernatorja Minxhozi, theksoi se me miratimin e kësaj strategjie është e nevojshme vijimi i përpjekjeve për promovimin e edukimit financiar në nivel kombëtar, si dhe intensifikimin dhe bashkërendimin e përpjekjeve për realizimin e *open banking* dhe *instant payment* në Shqipëri.

### ***Rekomandimet e mbledhjes së tetë të Komitetit Kombëtarë të Sistemit të Pagesave.***

Vijimin dhe intensifikimin e përpjekjeve në lidhje me:

- a) Zbatimin e masave për realizimin e objektivave të Strategjisë Kombëtare për Edukimin Financiar.
- b) Vijimin e përpjekjeve të aktorëve të tregut për realizimin dhe operacionalizimin e *openbanking* brenda afateve të parashikuara nga kuadri rregullativ në fuqi.

- c) Intensifikimin e përpjekjeve për realizimin e projektit *Instant Payment* në Shqipëri sipas propozimeve të Bankës së Shqipërisë në këtë mbledhje.

***Pjesëmarrja në mbledhje.***

<b>Të ftuar në mbledhjen e tetë të KKSP</b>		
<b>Institucioni</b>	<b>Emri</b>	<b>Pozicioni</b>
<b>Banka e Shqipërisë</b>	Z. Gent Sejko	Guvernator
<b>Ministria e Financave dhe Ekonomisë</b>	Znj. Delina Ibrahimaj	Ministër

<b>Anëtarët e KKSP në Mbledhjen e Tetë</b>			
<b>Institucioni</b>	<b>Emri i Anëtarit</b>	<b>Statusi në KKSP</b>	<b>Përfaqësuar të tjerë të institucionit</b>
<b>Banka e Shqipërisë</b>	Znj. Luljeta Minxhozi, Zëvendësguvernatore e Parë	Kryetare	
<b>Shoqata Shqiptare e Bankave</b>	Z. Bledar Shella Kryetar i Shoqatës Shqiptare të Bankave	Anëtar	
<b>Shoqata Shqiptare e Bankave</b>	Z. Spiro Brumbulli	Anëtar	Zj. Eftali Peci
<b>Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF)</b>	Zj. Mimoza Kaçi Zv Drejtor	Anëtar	
<b>Banka e Shqipërisë</b>	P/Zj. Valentina Semi Zv. Drejtor i Sistemit të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës	Anëtar	Zj. Amela Mehmeti Zj. Evis Çeli Zj. Edlira Hoxha
<b>Banka e Shqipërisë</b>	Z. Deniz Deralla, Drejtor, Departamenti i Mbikëqyrjes	Anëtar	Zj. Jonida Kacani
<b>Banka e Shqipërisë</b>	Z. Altin Tanku Drejtor, Departamenti i Kërkimeve	Anëtar	Zj. Besa Prela Zj. Arlinda Koleniço

<b>Banka e Shqipërisë</b>	Z. Donald Duraj Shef Kabineti, Kabineti i Guvernatorit	Anëtar	Zj. Ina Molla Zj. Erinda Çausi Zj. Brikena Arapaj
<b>Ministria e Financave dhe Ekonomisë</b>	Zj. Moza Peci	Anëtar	Zj. Aurela Velo Zj. Irena Xhafa Zj. Ina Buli
<b>Banka Botërore</b>	Z. Keler Gjika	Anëtar	Zj. Edlira Dashi
<b>Ambasada Zvicerane</b>	Zj. Sigita Stafa	Anëtar	
<b>Banka Kombëtare Tregtare</b>	Z. Kerem Pamuk	Anëtar	Zj. Anisa Liko
<b>ABI Bank</b>	Zj. Odeta Paloka	Anëtar	Zj. Majlinda Miho
<b>Credins Bank</b>	Zj. Suela Cela	Anëtar	Z. Dimirti Toslluku
<b>Fibank</b>	Zj. Ines Vucini	Anëtar	Zj. Elona Labinoti
<b>Intesa Sanpaolo Bank Albania</b>	Zj. Luci Shiroka	Anëtar	Zj. Xhilda Dafa
<b>Raiffeisen Bank</b>	Zj. Dezdemonax Gaxha	Anëtar	Z. Resmi Hibraj
<b>OTP Bank Albania</b>	Zj. Irida Huta	Anëtar	Zj. Ada Naqe
<b>Procredit Bank</b>	Zj. Erinda Ropi	Anëtar	Zj. Elena Jaku
<b>Tirana Bank</b>	Zj. Aida Gjoni	Anëtar	Zj. Linda Jakova
<b>Union Bank</b>	Zj. Fatbardha Rino	Anëtar	Zj. Valbona Cucka
<b>UBA</b>	Z. Ermal Husha	Anëtar	Zj. Adrian Guza
<b>E-Albania</b>	Zj. Nevila Repishti	Anëtar	
<b>Shoqata e Mikrokredivë</b>	Zj. Brunilda Isaj	Anëtar	
<b>Posta Shqiptare</b>	Zj. Anisa Kaltanji	Anëtar	
<b>VeloxPay SHPK</b>	Zj. Stela Shkodrani	Anëtar	
<b>AK INVEST</b>	Z. Geis Ceku	Anëtar	Z. Blendi Pustina
<b>Paylink</b>	Zj. Eneida Thomaj, Drejtor i Përgjithshëm	Anëtar	Z. Eriona Miraka Z. Dalip Bali

<b>Unioni Financiar Tiranë</b>	Z. Elton Çollaku, Drejtor i Përgjithshëm	Anëtar	Zj. Eriona Miraka Z. Dalip Bali
<b>Easy Pay</b>	Zj. Linda Shomo Drejtor i Përgjithshëm	Anëtar	Z.Endri Kote Z. Xhoxhi Beci
<b>MPay</b>	Zj. Bora Feri	Anëtar	
<b>Rubicon</b>	Z. Eno Kotmilo Z. Gentian Dekovi	Anëtar	
<b>Symetric Group SHPK</b>	Z. Elias Vounteris		Zj. Megi Xhafa
<b>Paysera</b>	Z. Taulant Piero	Anëtar	
<b>NOA</b>	Zj. Herjola Spahiu Drejtor i Përgjithshëm	Anëtar	Zj. Albana Pelinku Z. Ervin Gogaj
<b>RPAY</b>	Z. Akil Rajdho	Anëtar	Z. Noel Shehu